

VENDIM
Nr. 720, datë 13.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 354, DATË 16.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E RRUGËS PORTI I JAHTEVE–BYPASS ORIKUM–DUKAT (URA E SHËN ELIZËS)’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 354 datë 16.6.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë”, “truall”, “ndërtesë” dhe “pemëtore”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 23 128 876,3 (njëzet e tre milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë tre) lekësh.”.

b) Në pikën 4 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Vlera “20 838 377.3 (njëzet milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë tre) lekë” zëvendësohet me “23 128 876,3 (njëzet e tre milionë e njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje tre) lekë”;

ii. Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) vlera prej 2 290 499 (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve” në Bankën e Shqipërisë.”.

c) Tabelës bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

[illegible]